



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR**

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM,
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITERET PËR SHPALLJEN E OFERTËS FITUESE**

OBJEKTI I PROKURIMIT: *Studim projektim "Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Çorovodë"*

I mbajtur sot më datë 07.07.2023 , nga Njësia e Prokurimit, e përbërë nga Altin Lamçe, Kryetar (specialist i fushës), Ernest Ymeri, Anëtar (person përgjegjës për prokurimin) dhe Jona Koçi, Anëtare (Specialiste prokurimi), në zbatim të Urdhërit të Prokurimit nr.285 datë 05.07.2023.

Objekti i Prokurimit: Studim Projektim “Rikualifikim urban në lagjen “5 Shtatori” Çorovodë”

Fondi Limit: 7,301,480 lekë.

Procedura e Prokurimit: Shërbim Konsulence.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Skrapar** harton këtë procesverbal, për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim, specifikimeve teknike dhe kriteret për shpalljen e ofertës fituese, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

A. KRITERET PËR KUALIFIKIM

1. Kriteret e përgjithëshme të kualifikimit.

Ofertuesi do të deklarojë sipas kërkesave të pikës 1 të shtojcës 11 të Dokumenteve Standarte të Tendërit për procedurën “Shërbime Konsulence”, miratuar nga APP.

2. Kriteret e veçanta të kualifikimit

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5; Sigurimi i ofertës do të bëhet në shumën 2% të fondit limit, e shprehur në lekë **146,030** (njëqint e dyzet e gjashtë mijë e tridhjetë).*

c. *Kërkesën për pjesëmarrje, sipas shtojcës 1.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, ofertuesi duhet të dorëzojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera e të cilës të jetë sa 40% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë 2,920,592 pa TVSH. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
 - Vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për kontrata të realizuara në sektorin privat:
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- c) Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen edhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41, pika 3 e VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, për vitet financiare 2021 dhe 2022, vlera minimale e të cilës të jetë sa 40% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë 2,920,592 pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 1., pika 2. gwrma c) dhe pika 3. e VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) licencën profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, me katëgoritë e mëposhtme:

Kat. 2	a,d	Projektim arkitekturor për objekte banimi, projektim peizazhi, sistemime sipërfaqe të gjelbëra.
Kat. 4	i	Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve.
Kat. 5	e	Projektim kanalizeme urbane
Kat. 6	a	Projektim rrugë urbane dytësore
Kat. 9	a	Vlerësim gjeologo inxhinierik i trullit për objekte deri në 5 kate
Kat. 11	a	Projektim sinjalistikë jo ndriçuese në rrugë urbane dytësore....

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendim nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

Licensat e mësipërme, janë kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktor për shkak se lidhen ngushtë me objektin e prokurimit në të cilin kemi të bëjmë, sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit, me: *Kat.2 a) projektimin e fasadave të ndërtesave të bllokut deri në 5 kate*, pika 2.8 e detyrës së projektimit. *b) projektim peizazhi, sistemime sipërfaqe të gjelbëra të hapësirave të bllokut të banimit*, pika 2.9 e detyrës së projektimit. *Kat.4 i) Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve*, pika 2.4 e detyrës së projektimit. *Kat.5 e) Projektim kanalizeme urbane*, kanalizimet e ujrave të zeza dhe ujrave të bardha, sipas pikës 2.5 dhe 2.6 të detyrës së projektimit. *Kat.6 a) Projektim rrugë urbane dytësore*, të rrugëve të bllokut të banimit si dhe të rrugës “Dilaver Radëshi”, sipas pikës 2.1 të detyrës së projektimit. *Kat.9 a) Vlerësim gjeologo inxhinierik i trullit për objekte deri në 5 kate*, është i nevojshëm të bëhet për të parashikuar sistemimet e bllokut të banimit, gërmimet, muret mbajtëse, etj. pasi blloku i banimit ka kryesisht objekte 5 katëshe. *Kat.11 a) Projektim sinjalistikë jo ndriçuese në rrugë urbane dytësore*, sipas kërkesave të pikës 2.3 Siguria dhe sinjalistika rrugore, e detyrës së projektimit.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar pranë shoqërisë me kohë të plotë dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë për Studim – Projektim, Drejtuesit Teknikë të kërkuar më poshtë:

1	Arkitekt	1 (një)
2	Inxhinier Elektrik	1 (një)
3	Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
4	Inxhinier ndërtimi/ rrugë-hekurudha	1 (një)
5	Inxhinier Gjeolog	1 (një)

Si dhe inxhinierët dhe stafin e mëposhtëm, jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë

1	Inxhinier Gjeodet/ topograf	1 (një)
2	Inxhinier Mjedesi	1 (një)
3	Staf mbështetes për fushat e mësipërme.	4 (katër)

Për këtë duhet të parqitet

- një listë të inxhinierëve dhe stafit kryesor, të kërkuar më sipër,
- CV-të e tyre dhe licencat profesionale, sipas rastit
- listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për muajin Qershor 2023 (Formularet E-Sig 025/a.1).
- deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë, për secilin nga inxhinierët e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma b), c), d) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Për inxhinierët drejtues teknik që janë kërkuar, përputhen me kategoritë e kërkuara të licencës së subjektit dhe argumentimin e bërë në pikën 2.3 gërma a).
- Për inxhinierin Gjeodet/ topograf është kërkuar pasi është i domosdoshëm për realizimin e: topografisë së gjendjes egzistuese; profilat gjatësorë dhe tërthorë të rrugëve, etj. Kërkesa këto në detyrën e projektimit, pika 2.1 gërma a) dhe pika 9.2 ”Paraqitja e vizatimeve”.
- Për inxhinierin e mjedisit është kërkuar pasi është i domosdoshëm për realizimin e ”Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, sipas kërkesës së pikës 9.1. gërma d) e detyrës së projektimit.
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme, janë kërkuar 4 punonjës, të cilët mund të jenë inxhinierë të rinj, teknikë apo specialstë, për të ndihmuar inxhinierët e mësipër, në proceset e matjeve në terren, testimet e rrjeteve inxhinierike egzistuese, etj sipas kërkesave në detyrën e projektimit, në pikën 2.1 gërmat a), b) dhe c).

c) Mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e kontratës:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Pronësia
1	Paisje GPS Rover ose ekuivalente	1 (një)	Në pronësi ose me qera
2	Paisje Total Station	1 (një)	Në pronësi ose me qera

Për paisjet e kërkuara më sipër të paraqitet faturë tatimore e shitjes, në rastin kur janë në pronësi ose kontratë qeraje e noterizuar në rastin kur janë me qera, si dhe foto të tyre.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Paisje GPS Rover ose ekuivalente, është kërkuar pasi është i domosdoshëm për procesin e rilevimit të bllokut të banimit dhe sidomos të fasadave të pallateve, kërkesa këto të detyrës së projektimit në pikën 2.1. gërma a) dhe pikën 2.8.
- Paisje Total Station, është kërkuar pasi është i nevojshëm sidomos për projektet e rrugëve, hartimin e profilave tërthorë e gjatësorë, kërkesa këto të detyrës së projektimit në pikën 6.1.

2.4. Kërkesat e cilësisë

Për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, ofertuesit duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e shërbimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente)
- ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor) (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (Siguria dhe shëndeti në punë) (ose ekuivalente)

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1).

B. SPECIFIKIMET TEKNIKE, TERMAT E REFERENCËS

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka hartuar Detyrën e Projektimit, në të cilën janë trajtuar, të gjitha kërkesat në lidhje me realizimin e shërbimit të “Studim projektim- Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Çorovodë”.

Janë përcaktuar:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Paraqitja e vizatimeve

Afatet e realizimit të shërbimeve dhe mënyra e raportimit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Detyra e Projektimit, do të jepet bashkëlidhur dokumenteve të tenderit.

Për pasojë, kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

C. KRITERET E VLERËSIMIT

Njësia e prokurimit, miraton Kriteret e përzgjedhjes së fituesit e cila do të jetë:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto:

Çmimi më i ulët do të vlerësohet me **100 pikë**.

dhe

Propozimi teknik, do të vlerësohet maksimalisht **100 pikë**:

Kriteret e Vlerësimit teknik	Pikët
(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]
(ii) Metodologjia e Propozuar (Përfaqsjë teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)	[20-30]
(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	[20-60]

(iv) Transferimin e Njohurive, (nuk kërkohet)

10 pikët i shtohen kriterit ” Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar”

Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë = $X + Y$

Informacione më të hollësishme jepen në seksionin “Udhëzime për Operatorin Ekonomik”, pjesë e Dokumenteve Standarte të Tenderit për procedurën “Shërbim Konsulencë”.

D. PËRFUNDIME

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit , si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte te Tenderit, për procedurën “Shërbim Konsulencë”me objekt prokurimi “*Studim projektim "Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Çorovodë"*”. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Kryetar
Altin Lamçe

Anëtar
Ernest Ymeri

Anëtare
Jona Koçi